

LIGJ
Nr.8293, datë 26.2.1998

PËR POLICINË KRIMINALE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Policia kriminale është strukturë e specializuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Ministrinë e Brendshme dhe në organet e saj vartëse në bazë për të luftuar kriminalitetin.

Neni 2

Veprimtaria e policisë kriminale realizohet në mënyrë të hapur ose të fshehtë për të mbrojtur jetën, shëndetin, pasurinë, të drejtat dhe liritë e njeriut, sigurinë sociale e shtetërore nga veprimtaria kriminale në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Veprimtaria e policisë kriminale bazohet në parimin e ligjshmërisë, të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, të ruajtjes së sekretit dhe të bashkërendimit të veprimeve të hapura e të fshehta.

Neni 4

Bazat ligjore të veprimtarisë së policisë kriminale janë :

- dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;
- ky ligj;
- ligjet e tjera që e ngarkojnë me detyra policinë kriminale;
- aktet nënligjore të dala nga Këshilli i Ministrave dhe titullari i Ministrisë së Brendshme brenda kompetencave të tij.

Neni 5

Policia kriminale ka për detyrë:

- zbulimin, parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale, evidencimin dhe kapjen e personave që kanë kryer, kryejnë ose përgatiten të kryejnë krime me dashje;
- të kryejë gjurmimin policor për krimet e kryera me dashje.

Format e metodat për realizimin e gjurmimit policor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

- kërkimin e personave që u fshihen organeve të prokurorisë e gjykatës, që i shmangen dënimit penal ose që konsiderohen të humbur.

Neni 6

Policia kriminale, për zbatimin e detyrave të saj të përcaktuara në këtë ligj, ka të drejtë të grumbullojë informacione e të dhëna nga subjekte shtetërore, shoqërore, fizike e juridikë.

Punonjësit zyrtarë të policisë kriminale zgjidhin detyra të veprimtarisë së kësaj policie, duke marrë pjesë personalisht, duke shfrytëzuar ndihmën e personave të tjerë zyrtarë e të specialistëve, që

zotërojnë njohuri shkencore e teknike të veçanta, si dhe bashkëpunojnë në mënyrë të hapur e të fshehtë me qytetarë të veçantë.

Neni 7

Nënshtetësia, kombësia, gjinia, vendbanimi, pozita shoqërore e ekonomike dhe bindjet fetare e politike të personave të veçantë nuk përbëjnë pengesë në zbatimin e veprimtarisë së policisë kriminale.

Neni 8

Policia kriminale kryen veprime kur:

- a) ka kërkesë nga organi kompetent që nis procedimin, gjykon çështjen penale ose ekzekuton vendimin penal për veprime të caktuara procedurale për kërkimin e personit;
- b) ka çështje penale të pezulluara;
- c) ka informacione për përgatitjen ose kryerjen e një vepre penale me dashje;
- d) gjendet një kufomë e paidentifikuar;
- e) është njoftuar ose shpallur zhdukja e personit.

Neni 9

Nuk lejohet të kryhen veprime nga policia kriminale për të realizuar qëllime dhe detyra që nuk parashikohen në këtë ligj.

Personat që mendojnë se veprimet e policisë kriminale nuk janë të bazuara në ligj ose çojnë në kufizimin e të drejtave e të lirive të tyre, u lind e drejta të ankohen në instanca më të larta ose në gjykatë. Në rastet kur ankimi shqyrtohet në gjykatë, me kërkesën e saj, policia kriminale është e detyruar të paraqesë me një relacion veprimet e kryera në masën që përjashtojnë përhapjen e sekretit shtetëror.

Policisë kriminale i ndalohet të ndërmarrë veprime në interes ose në mbështetje të partive politike, të kryejë veprime të fshehta pa lejen e gjykatës në veprimtarinë e organeve shtetërore të zgjedhura, të administratës shtetërore, të organeve të drejtësisë dhe të komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

Veprimet e policisë kriminale që bien në kundërshtim me këtë ligj, sjellin përgjegjësi sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Rezultatet e veprimtarisë së policisë kriminale për krimet me dashje vihen në dispozicion të organeve të policisë gjyqësore, prokurorisë a gjykatës dhe shërbejnë si bazë për të kërkuar nisjen e procedimit penal ose për parandalimin a zbulimin e veprave penale.

Informacionet e grumbulluara nga policia kriminale si pasojë e verifikimeve të ndryshme që ajo bën, nuk përbëjnë bazë për kufizimin e lirive e të të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë.

Neni 11

Policia kriminale është e detyruar gjatë veprimtarisë së saj :

- të marrë, në përputhje me kompetencat e saj, të gjitha masat e domosdoshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e personit të garantuara me ligj, pronën dhe sigurinë shoqërore e shtetërore;
- të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kërkesat e Kodit të Procedurës Penale;
- të respektojë rregullat e ruajtjes së sekretit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
- të informojë e të bashkëpunojë me organe të tjera, si Shërbimi Informativ Kombëtar, Shërbimi Informativ i Ushtrisë, Shërbimi Informativ i Rendit, policitë e shteteve të tjera ose organizmat policorë ndërkombëtarë, me miratim të organit kompetent shtetëror të përmendur në

marrëveshjet dy ose shumëpalëshe ose në aktet e tjera ligjore e nënligjore, si dhe me organet e tjera të administratës shtetërore, për veprime të kundërligjshme që në bazë të ligjit janë në kompetencë të tyre;

- të ndihmojë në garantimin e sigurisë së personit, pavarësisht nga pozita e tij, ruajtjen e pronës së tij dhe të anëtarëve të familjes, si dhe të personave të tjerë që janë subjekte në procedime penale a gjyqësore, nga kërcënimet ose nga veprime të tjera të kundërligjshme.

Neni 12

Për plotësimin e detyrës policia kriminale ka të drejtë gjatë veprimtarisë së saj:

1. të kryejë hapur ose në mënyrë të fshehtë veprimet e saj të parashikuara në këtë ligj;

2. të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi me shpërblim ose me kontratë me persona që me pëlqimin e tyre mund të tërhiqen në shërbim të policisë kriminale, duke ruajtur bashkëpunimin me policinë. Këta persona janë të detyruar të ruajnë sekretin e informatave, qënien në këtë bashkëpunim, si dhe të mos japin informata të rreme;

3. të përdorë në fshehtësi të plotë dokumente që deshifrojnë individualitetin e personave shtetërorë e privatë që marrin pjesë në veprimtarinë e policisë kriminale, si dhe individualitetin e personit që bashkëpunon me policinë kriminale.

Neni 13

Për zbulimin e veprave me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, policia kriminale shfrytëzon me kontratë ose me marrëveshje verbale, me pëlqim të dyanshëm, pronën e subjekteve juridike private.

Vepra me rrezikshmëri të theksuar shoqërore në kuptim të këtij ligji konsiderohen:

- krimet kundër jetës së personit;
- krimet seksuale me dhunë dhe ndaj të miturve;
- rrëmbimi i personit dhe i mjeteve të transportit;
- krimet në fushën e drogës;
- kontrabanda;
- trafiku i paligjshëm i armëve dhe i veprave të artit;
- aktet terroriste;
- bandat dhe organizatat kriminale;
- vjedhjet me dhunë, me armë dhe me pasoja vdekjeje.

Neni 14

Shtetasit, personat zyrtarë, punonjësit e administratës shtetërore dhe të zgjedhurit kanë për detyrë të mos pengojnë punonjësit e policisë kriminale në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tyre.

Neni 15

Oficerët dhe nënoficerët që kryejnë detyra në policinë kriminale, kanë garanci juridike e mbrojtje sociale të posaçme, e cila sigurohet nëpërmjet statusit të ushtarakut dhe ligjeve të tjera.

Ndalohet vlerësimi i punës i punonjësve të policisë kriminale bazuar në indeksin sasior të rezultateve.

Personat e ngarkuar për ushtrimin e veprimtarisë së policisë kriminale u nënshtrohen drejtpërsëdrejti dhe pa ndërmjetësi urdhrave të eporit të drejtpërdrejtë më të afërt. Kur ai merr urdhra a udhëzime që bien në kundërshtim me ligjin, është i detyruar të udhëhiqet vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe, në qoftë se ai ka bazë logjike e profesionale të mendojë se si pasojë e zbatimit të urdhrave e udhëzimeve ka çuar ose mund të çojë në kryerjen e një krimi, të njoftojë menjëherë instancën më të lartë, nga e cila ai varet ose Prokurorin e Përgjithshëm.

Neni 16

Personat që bashkëpunojnë me policinë kriminale janë në mbrojtjen e shtetit dhe kanë garanci juridike e sociale.

Kur lindin kërcënime reale që rrezikojnë jetën, shëndetin e pasurinë e personave, të familjes dhe të të afërmeve të tyre, si pasojë e bashkëpunimit me policinë kriminale, Ministria e Brendshme është e detyruar të marrë masat e nevojshme për parandalimin e tyre dhe garantimin e sigurisë së jetës e të pronës të personave të lartpërmendur.

Të dhënat që lidhen me identitetin ose punën që ka bërë personi, i cili ka bashkëpunuar me policinë kriminale, përbëjnë sekret shtetëror dhe mund të ekspozohen vetëm me miratimin me shkrim nga vetë personi.

Personat që bashkëpunojnë me policinë kriminale, shpërblehen nga fondi i veçantë i Ministrisë së Brendshme.

Shteti i garanton qytetarit, që ka pranuar bashkëpunimin mbi bazën e kontratës me policinë kriminale, plotësimin e detyrimit të kontratës.

Me qëllim që të sigurohet shmangia e rrezikshmërisë, që i kanoset personit që bashkëpunon me policinë kriminale dhe pjesëtarëve të familjes së tij, lejohen të zbatohen masa speciale që përcaktohen nga ministri i Brendshëm.

Në rast se personi që bashkëpunon me policinë kriminale vritet si pasojë e këtij bashkëpunimi, familjes së viktimës dhe personave që jetojnë me të ardhurat e tij, i jepet një ndihmë financiare e menjëhershme e barasvlershme me pagën e 10 vjetëve mbi bazën e profesionit fillestar ose mbi bazën e pagës mujore të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, dhe për pesë vjet kur ai pëson dëmtime e kontuzione gjymtyrësh që kanë çuar në përjashtimin e mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm. Shpenzimet përballohen nga buxheti i Ministrisë së Brendshme.

Neni 17

Për të siguruar prova për vërtetimin e fajësisë në krimet e rënda sipas kuptimit të këtij ligji, policisë kriminale i lejohet të blejë, kundrejt dokumentacionit përkatës, një nga provat e fajësisë me miratimin e drejtorit të policisë kriminale. Drejtoria e Policisë Kriminale për përdorim të shpejtë, mban në dispozicion shumën prej 1 milion lekësh, e cila merret nga buxheti i Ministrisë së Brendshme.

Neni 18

Në strukturat e policisë kriminale mund të punojnë me cilësinë e oficerit shtetasit shqiptarë që kanë mbaruar Akademinë e Lartë të Ministrisë së Brendshme. Për raste të veçanta e për interesa të punës së policisë kriminale mund të punojnë në strukturat e kësaj policie edhe shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar arsimin e lartë, pasi të kenë kryer më parë kurse kualifikimi për policinë kriminale.

Në policinë kriminale mund të punojnë me cilësinë e nënoficerit shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shërbimin e detyrueshëm ushtarak e që kanë kryer arsimin e mesëm dhe shkollën 1-vjeçare të policisë ose kurse kualifikimi për policinë kriminale.

Neni 19

Punonjësit e policisë kriminale pajisen me dokument identifikimi që tregon qenien e tij në strukturat e policisë kriminale dhe sektorin përkatës dhe e paraqet atë sa herë që e sheh të nevojshme gjatë ushtrimit të detyrës.

Ata janë të pajisur me armatimin personal dhe trajtohen me veshje civile.

Neni 20

Në buxhetin e Ministrisë së Brendshme përcaktohen fondet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së policisë kriminale.

Neni 21

Askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në veprimtarinë e policisë kriminale, me përjashtim të personit të ngarkuar me ligj. Të drejtën e kontrollit të veprimtarisë funksionale të policisë kriminale e kanë Këshilli i Ministrave, ministri i Brendshëm, prokurori i Përgjithshëm dhe komisioni përkatës i Kuvendit Popullor.

Neni 22

Punonjësit e policisë kriminale janë të detyruar të zbatojnë këtë ligj, për aq sa parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare, edhe në veprimet që kryejnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 23

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Brendshme.

Neni 24

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri i Brendshëm të nxjerrin aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Ligji nr.7549, datë 14.1.1992 “Për metodat e punës së policisë kriminale” shfuqizohet.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2008, datë 3.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani